Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS	KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE	KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

RAPORT PËRMBLEDHËS

GJENDJA E AJRIT

2015

AKMM

Prishtinë, Janar 2016

Përmbajtja

1. Hyrje

2. Cilësia e ajrit

3. Emisionet në ajër nga operatoret industrial; KEK, Feronikel dhe Sharrcem

3.1. KEK

3.2. Feronikel

3.3. Sharrcem

1. HYRJE

AKMM sipas legjislacionit mjedisor dhe planit të fushëveprimit të saj mbulon tri fusha me kryesore mjedisore:

- Monitorimin e gjendjes së mjedisit,
- Sistemin e informatave mjedisore dhe
- Raportimin për gjendjen e mjedisit.

Përkundër shumë vështirësive, AMMK deri me tani ka vënë një bazë të mirë dhe përvojë në monitorimin e mjedisit bazuar në standardet dhe indikatorët mjedisorë Evropian dhe kombëtar.

Po ashtu, AMMK-së, është edhe në proces të themelimit të një sistem të informimit mjedisor që do të siguronte informacionin e duhur dhe me kohë për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit si dhe raportimet ne Agjencinë e Mjedisit të Evropës.

Si rezultat i të dhënave të grumbulluara dhe të përpunuara, AMMK harton raporte për gjendjen e përgjithshme të mjedisit në Kosovë, si dhe të raporte për sektorët kryesor (ajrin, tokën, ujin, mbeturinat, llojllojshmërinë biologjike, ndryshimet klimatologjike etj.)

AKMM, bënë monitorimin e mjedisit përmes matjeve sistematike, hulumtimit dhe vlerësimit të indikatorëve mjedisor.

Të dhënat e grumbulluara nga monitorimi i gjendjes së mjedisit, përbëjnë informacion publik dhe përfshihen në Sistemin Informativ të Mbrojtjes së Mjedisit.

Raporti përmbledhës për gjendjen e ajrit përfshinë gjendjen e cilësisë së ajrit dhe emisionet nga operatoret ndotës për vitin 2015. Burim kryesor i të dhënave për këtë raport janë raportet mujore për cilësi të ajrit nga IHMK dhe raportet mujore për emisione nga operatorët ekonomik: KEK, Feronikeli dhe Sharrcemi.

2. Cilësia e ajrit

Cilësia e ajrit, në këtë raport pasqyron gjendjen për territorin e Kosovës ku ka janë realizuar matje nga stacionet për monitorim kontinual të cilësisë së ajrit. Burim kryesor i të dhënave janë raportet mujore, të cilat janë rezultat i matjeve nga stacionet monitoruese të cilësisë së ajrit e të cilat janë nën menaxhimin e IHMK.

Raporti përmbledhës përfshin vlerat mesatare mujore nga rezultatet e sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit në stacionet e rrjetit nacional. Duhet të potencohet se nuk ka pasur të dhëna kontinuale nga disa stacione monitoruese dhe kjo e vështirëson vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes së ajrit. Ky fakt dhe mangësi tjera nuk janë objekt i shqyrtimit të këtij raporti, kështu që janë analizuar të dhënat, të cilat kanë qenë në dispozicion. Të dhënat janë pranuar dhe analizuar nga 12 stacionet monitoruese.(Tab.1)

Tab. 1. Stacionet monitoruese për cilësinë e ajrit

Nr.	**Emërtimi i Stacionit monitorues**	**Shenja e Stac.**	**Lokacioni**	**Institucioni përgjegjës**	**Parametrat që maten**	**Tipi i zonës**
1	IHMK	KS0101	IHMK,Prishtinë	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2, NO_x,O_3,CO	Sfondi urban
2	Rilindja	KS0102	Oborri i Rilindjes, Prishtinë	IHMK	PM10,PM2.5,03	Sfondi urban
3	Pejë	KS0305	Sh. fillore "Lidhja e Prizrenit"	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2, NO_x,O_3,CO	Sfondi urban
4	Prizren	KS0406	Kuvendi Komunal	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2,	Sfondi urban
5	Brezovicë	KS0507	Zona e skijimit	IHMK	PM10,PM2.5,	Sfondi urban
6	Hani I Elezit	KS0508	Sh.fillore "Ilaz Hallaqi"	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x,O_3,CO	Sfondi urb./in.
7	Gjilan	KS0609	Kuvendi Komunal	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x,O_3,CO	Sfondi urban
8	Drenas	KS0103	Kuvendi Komunal	IHMK	PM10,PM2.5 ,SO_2,NO_x,CO	Sfondi urban
9	Obiliq	KS0110	QMF	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x,O_3,CO	Sfondi urban
10	Dardhishtë	KS0111	Shkolla fillore	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x,O_3,CO	Sfondi industrial
11	Palaj	KS0112	Kosova Mont	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x,O_3,CO	Sfondi industrial
12	Mitrovicë	KS0204	Stacioni i meteorologjisë	IHMK	CO,O_3,PM10,PM2.5	Sfondi urban

Tab.2 Normat e cilësisë së ajrit sipas Udhëzimi Administrativ Nr.02/2011.

Parametri	Vlerat limite	Njësia matëse	Vlera limite(kufitare) µg/m³	Tejkalimet e lejuara brenda vitit
NO2	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	200	18
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	40	Nuk parashihet
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e vegjetacionit	µg/m³	30	Nuk parashihet
SO2	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	350	24
	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	125	3
CO	Vlera limite për mesataren ditore te maksimales 8-orëshe, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	mg/m³	10	Nuk parashihet
PM10	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	50	35
PM2.5	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	40	Nuk parashihet
	Viti kalendarik	µg/m³	25	Nuk parashihet
O3	Objektivi afatgjatë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	120	Nuk parashihet
	Pragu i informimit	µg/m³	180	Nuk parashihet
	Pragu i alarmit	µg/m³	240	Nuk parashihet

Ndotja e theksuar vërehet nga pluhuri në formë të PM10 dhe PM2.5, ndërsa parametrat tjerë nuk tejkalojnë Vlerën Maksimale të lejuar (VML).
Dallojnë stacionet e monitorimit në Obiliq me 90 ditë tejkalime të VML brenda vitit, Gjilani me 75, Prishtinë-IHMK me 74, Prishtinë-Rilindja me 66, Drenasi me 61 dhe Hani i Elezit me 45 ditë tejkalime, **krahas 35 ditë sa janë të lejuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011 për normat e cilësisë së ajrit.**
Përmbledhja e këtij raporti prezantohet përmes tabelave dhe grafikonëve bazuar në vlerat mesatare të rezultateve të matjeve 24-orëshe dhe mesatares vjetore të këtyre vlerave.

Tab.3. PM10/PM2.5-Mesatarja vjetore për vitin 2015

	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	**2015**	**2015**
	Lokac. e monitorimit	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	**Mes. vjetore**	**Tejkalime Ditë**
VMDL,PM10/VMVL **µg/m³** 50/40 (mujore/vjetore),lejohen 35 ditë /vit	IHMK	74.93	45.3	31.48	31.25	27.8	23.37	24.7	26.9	25.3	30.6	62.68	79.0	40.27	74
	Rilindje	51.72	54.4	38.95	26.99	24.38	20.81	35.03	37.10	32.9	36.2	65.12	83.21	60.58	66
	Drenas	50.9	52,1	30.12	*	*	*	*	*	45.76	38.7	108.63	67.39	54.82	61
	Mitrovicë	62.1	60.58	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	61.34	13
	Pejë	73.95	48.78	25.25	19.18	13.67	12.20	12.76	7.97	*	*	*	*	23.56	7
	Prizren	79.77	67.1	*	*	9.06	8.95	11.34	*	*	*	*	*	35.24	22
	Brezovicë			*	*	*	*	*	*	*	*	*	*		
	Hani i Elezit	36.82	44.31	*	23.22	*	17.7	26.14	18.5	*	61.4	44.3	56.7	36.56	36
	Gjilan	124	63.58	66.34	74.35	54.21	42.04	44.00	40.0	*	*	*	*	63.56	74
	Obiliq	165.7	64.69	49.74	*	*	*	*	*	*	44.8	93.36	100.7	86.49	95
	Dardhishtë	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*		
	Palaj	87.83	46.7	31.41	32.7	29.0	28.5	38.8	39.12	*	*	*	*	41.75	32
VMLPM2.5- **µg/m³ vjetore, 25**	IHMK	70.15	34	21.81	15.42	11.49	10.79	11.4	12.0	25.3	30.6	47.2	72.0	30.18	
	Rilindje	44.62	34.3	25.66	16.86	9.63	10.23	13.14	22.55	14.58	21.86	54.14	68.42	27.99	
	Drenas	*	20,1	20.81	*	*	*	*	*	20.16	23.81	71.62	67.39	40.75	
	Mitrovicë	*	49.4	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	49.4	
	Pejë	33,6	3,1	20.89	15.30	5.92	5.68	6.69	6.41	*	*	*	*	10.14	
	Prizren	85.63	5,1	*	*	*	*	**5.63**	2.9	*	*	*	*	31.38	
	Brezovicë			*	*	*	*	*	*	*	*	*	*		
	Hani i Elezit	7.9	4.47	*	1.66	*	1.30	1.38	1.12	*	9.52	10.5	13.5	5.70	
	Gjilan	113.2	60.4	40.76	28.0	*	*	15.6	23.4	*	*	*	*	56.89	
	Obiliq	155.9	50.2	41.56	*		*	*	*	*	33.7	70.9	92.33	74.09	
	Dardhishtë	*		*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	29.9	
	Palaj	64,0	29.9	20.63	15.21	12.61	12.48	18.0	17.95	*	*	*	*	16.14	

Tab.4. SO_2, $\mu g/m^3$ -Mesatarja vjetore për vitin 2015

	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	**2015**
	Lokac. e monitorimit	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	**Mes. vjetore**
VML 125 µg/m³ për 24 orë, Lejohen 3 ditë me tejkalime	IHMK	5.86	1.07	1.08	1.34	1.75	1.08	3.12	2.9	4.34	4.7	8.3	10.9	3.87
	Rilindje	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	
	Drenas	55.39	57.8	58.9	*	*	*	52.7	*	3.06	6.23	17.18	14.67	33.24
	Mitrovicë	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	
	Pejë	3.01	3.01	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	3.01
	Prizren	4.27	4.27	*	*	5.05	3.06	9.61	6.62	*	*	*	*	5.48
	Brezovicë	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	
	Hani i Elezit	14.4	5.59	*	15.73	*	29.08	32.22	32.22	*	38.5	40.3	42.9	27.88
	Gjilan	125.1	12.6	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	68.85
	Obiliq	55.9	78.8	9.68	*	*	*	*	*	*	*	*	*	44.24
	Dardhishtë	30.6	21.7	7.59	12.4	2.78	1.70	*	*	*	*	*	*	9.23
	Palaj	56.9	48.6	5.37	3.13	1.73	1.60	8.85	8.85	7.59	5.48	4.63	7.28	9.37

Tab.5. CO, mg/m³--Mesatarja vjetore për vitin 2015

	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	**2015**
	Lokac. e monitorimit	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	**Mes. vjetore**
VML **mg/m³ 10„ për mesatarën ditore, brenda vitit**	IHMK	3,09	3.08	4.18	3.40	3.34	3.23	3.29	3.89	7.2	4.58	5.5	6.65	4.39
	Rilindje	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
	Drenas	*	*	*	*	*	*	*	*	0.45	0.65	1.14	1.45	0.92
	Mitrovicë	*	2.1	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	2.1
	Pejë	3.5	0.9	3.99	4.49	5.43	4.76	*	*	*	*	*	*	3.84
	Prizren	4.95	1.3	*	*	2.95	2.79	4.13	3.85	*	5.0	6.7	*	3.95
	Brezovicë	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
	Hani i Elezit	0.27	0.38	*	1.04	*	0.79	1.30	1.3	*	1.13	0.9	1.05	0.90
	Gjilan	5.32	1.94	1.37	1.15	1.16	1.80	1.49	1.53	*	*	4.08	4.5	2.43
	Obiliq	*	2.33	1.71	*	*	*	*	*	*	*	*	*	2.02
	Dardhishtë	1.61	1.01	0.85	0.39	0.27	0.23	*	*	*	*	*	*	0.55
	Palaj	1.54	1.15	1.21	0.33	0.32	0.31	0.41	0.41	*	*	*	*	0.71

Tab.6. NO_2 , $\mu g/m^3$--Mesatarja vjetore për vitin 2015

	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	**2015**
	Lokac. e monitorimit	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	**Mes. vjetore**
VML µg/m³ 40, vlerë mestare vjetore	IHMK	25.5	18.1	16.41	16.92	15.64	15.45	32.31	34.78	31.9	31.9	43.2	45.1	27.26
	Rilindje	27.65	28.27	24.2	19.67	22.68	17.93	21.61	37.80	53.3	37.6	41.3	51.1	31.92
	Drenas	*	*	*	*	*	*	6.69	8.49	19.23	18.81	31.56	26.3	18.51
	Mitrovicë	*	8.1	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	8.1
	Pejë	19.1	5,4	5.2	4.88	4.47	3.12	*	*	*	*	*	*	7.354
	Prizren	43.2	12,2	*	*	14.36	15.64	24.25	18.25	*	3.85	31.9	*	21.63
	Brezovicë	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
	Hani i Elezit	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
	Gjilan	60.3	20.1	29.53	33.55	27.8	*	45.68	37.6	*	*	31.3	32.3	35.35
	Obiliq	46.3	20.3	11.78	*	*	*	*	*	*	*	*	*	29.04
	Dardhishtë	28.3	13.1	10.73	9.97	8.07	6.96	*	*	*	*	*	*	12.85
	Palaj	18.3	7.7	3.33	2.36	4.44	3.96	8.91	8.91	*	17.6	10.49	17.9	9.44

Tab.7. O3 µg/m3--Mesatarja vjetore për vitin 2015

	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	**2015**
	Lokac. e monitorimit	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	**Mes. vjetore**
VML µg/m3 120, vlerë mestare vjetore	IHMK	*	*	*	35.8	31.8	35.05	77	74.2	36.1	37.6	26.4	13.1	40.78333
	Rilindje	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
	Drenas	*	*	*	*	*	*	93.6	81.02	49.72	33.4	17.26	12	47.83333
	Mitrovicë	*	18.2	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	18.2
	Pejë	6.1	15,1	77.84	44.56	*	*	*	*	*	*	*	*	42.83333
	Prizren	10.4	20,1	*	*	66.8	75	*	10.32			*	*	40.63
	Brezovicë	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	
	Hani i Elezit	50.8	32.7	*	73.6	*	103.34	126	100.6		50.4	52	55.2	71.62667
	Gjilan	4.78	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	4.78
	Obiliq	23.8	23.3	23.51	*	*	*	*	*	*	*	*	*	23.51
	Dardhishtë	35.1	47.1	51.91	51.7	56	60.9	*	*	*	*	*	*	53.522
	Palaj	30.4	38.2	42.78	46.28	45.11	48.59	27.9	49.17	51.34	35.24	24.24	11.79	38.19096

Tab.8. PM10-Ditët me tejkalime 2015

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	**2015**
Lokac. e monitorimit	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	Mes. mujore	**Tejkalime Ditë**
IHMK	8	10	**3**	**2**	1	1	*		1	5	20	23	74
Rilindje	3	8	**4**	0	**0**	0	*	1		5	21	24	66
Drenas	4	5	**2**	*		*			8	6	18	18	61
Mitrovicë	5	8	*	*	*							*	13
Pejë	3	4	**0**	**0**	**0**	**0**						*	7
Prizren	16	6	*	*	0	0						*	22
Brezovicë	6	4	*	*	*	*						*	10
Hani i Elezit	6	13	*	0	*	0				6	7	13	45
Gjilan	7	11	**21**	28	8	3	2	2				*	82
Obiliq	17	13	**10**	*	*	*				6	22	27	95
Dardhishtë	*		**4**	*	*	*						*	4
Palaj	7		8	4	1	**1**	6	5				*	32
	82	82	52	34	10	5	8	8	9	28	88	105	511



Harta e mesatareve vjetore te PM10 sipas stacioneve monitoruese



Figura 1. Mesatarja vjetore e PM10 per vitin 2015



Figura 2. Mesatarja vjetore e PM2.5 per vitin 2015



Figura 3. Mesatarja vjetore e SO_2 per vitin 2015



Figura 4. Mesatarja vjetore e CO per vitin 2015



Figura 5. Mesatarja vjetore te NO_2 per vitin 2015



Figura 6. Mesatarja vjetore te Ozonit per vitin 2015

3. Emisionet në ajër nga operatoret industrial; KEK, Feronikel dhe Sharrcem

Ndikimet në mjedis nga Termocentralet, Feronikel dhe Sharrcem vlerësohen se janë mjaft të theksuara. Në veçanti Prodhimi i energjisë ka ndikim të ndjeshëm në mjedis, për shkak të operacioneve të cilat e përcjellin, që nga sigurimi i lëndës së parë, transportit të saj e deri te procesi i prodhimit dhe vet shfrytëzimi i energjisë.

Kompleksi Industrial i Feronikelit përbëhet nga Shkritorja dhe dy Miniera sipërfaqësore, ajo e Çikatovës dhe e Gllavicës ku eksploatimi i xehes është sipërfaqësore, mirëpo, kohë pas kohe bëhet edhe furnizimi me xehe nga importi.

Me punën që bënë gjatë procesit të prodhimit të Fe-Ni metalik ky kompleks ndikon në lirimin e sasisë së madhe të pluhurit si dhe gazrave (CO, CO2, SO2, NOx) të cilat kanë ndikim në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

Fabrika e Sharrcemit ndikon në ndotjen e ajrit me oxhakun e furrës si rezultat i zbërthimeve fiziko-kimike të lëndës së parë. Si burimet tjera potenciale të ndotjes janë edhe mullijtë për bluarjen e çimentos, depoja e klinkerit, sistemi i paketimit dhe transportit të prodhimeve të gatshme.

Sistemi aktual i filtrimit të gazrave dhe pluhurit nga oxhaku i furrës behet përmes filtrit elektrostatik (ESP) Prandaj e procesi i monitorimit ju referohet përcjelljes se emisioneve nga oxhaku kryesor I furrës ne te cilin bëhen matjet e emisioneve te pluhurit , gazrave te NOx , SO2, CO, O2, temperaturës shpejtësisë se gazrave dhe rrjedhja vëllimore.

3.1 KEK -Vlerësimi i emisioneve në Termocentralet A –B për vitin 2015

Sipas Direktivës 2001/80/EC, si dhe UA nr./2007 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e pa lëvizshme të ndotjes me djegie të madhe.

- ***SO_2***.....*400 mg/Nm^3*
- ***NOx***.....*500 mg/Nm^3*
- ***Pluhur***.....*50 mg/Nm^3*

Më poshtë janë paraqitur grafikisht emisionet e Pluhurit, SO2 dhe NOx në Termocentralet Kosova A dhe Kosova B gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2015.
Parametrat e SO_2, NOx dhe CO_2 janë kalkuluar (përveç emisionit të pluhurit, i cili matet) në TCA , ndërsa në TCB janë të matura të gjithë parametrat.

Emisionet e Pluhurit në mg/Nm3

Në figurën 1, janë paraqitur emisionet e pluhurit në TC A dhe në TC B, nga shihet se në TC A nuk ka pasur tejkalim gjatë muajve Janar – Dhjetor, ndërsa në TC B vlerat janë shumë të larta.
Vlen të ceket se në TC B vlerat e emisioneve të pluhurit nga muaji Mars janë gjithmon duke u zvogluar. Po ashtu vërehet se nga Tetori – Dhjetor ka ngritje.



Fig.7. Emisionet e Pluhurit në mg/Nm³, Janar – Dhjetor, 2015

Emisionet e SO_2 në mg/Nm3

Në figurën 2, janë paraqitur emisionet e SO_2 në TC A dhe në TC B.
Në TC A shihet se vetëm gjatë muajit Janar ka pasur tejkalim, kurse në muajt tjerë nuk ka pasur tejkalime. Në TC B gjatë krejt muajve ka pasur tejkalime. Vlen të ceket se gjatë muajit Tetor dhe Dhjetor në TCB nuk ka pasur tejkalim.



Fig.8. Emisionet e SO_2 në mg/Nm³, Janar – Dhjetor, 2015

Emisionet të NOx në mg/Nm3

Në figurën 3, janë paraqitur emisionet e NOx në TC A dhe në TC B, nga shihen tejkalime gjatë krejt muajve si në TC A poashtu edhe në TC B.



Fig.9. Emisionet e NOx në mg/Nm3, Janar – Dhjetor, 2015

3.2. Feronikel- Vlerësimi i emisioneve në ajër për vitin 2015

Më poshtë janë të paraqitur në mënyrë grafike emisionet e Pluhurit, SO2 dhe NOx të matura në në furrat rrotulluese.

Emisionet e matura të Pluhurit në mg/Nm3

Në fig. 10, janë paraqitur emisionet e pluhurit në Ferronikel, gjegjësisht në furrat rrotulluese,nga shihet se nuk ka tejkalime nga vlerat e lejuara gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2015.
Vlen të ceket se në Shtator dhe Tetor kemi pasur vlera më të ulëta të emisioneve të pluhurit në krahasim me muajt paraprake.



Fig.10. Emisionet e matura të Pluhurit në mg/Nm³, Janar – Dhjetor, 2015

Emisionet e matura të SO_2 në mg/Nm³

Në fig. 11 janë paraqitur emisionet e SO_2 në Ferronikel, gjegjësisht në furrat rrotulluese, nga shihen se gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2015 nuk ka pas tejkalime nga vlerat e lejuara.
Vlen të ceket se gjatë muajve Gusht, Shtator dhe Tetor ka pas vlera më të ulëta të emisioneve të SO_2 në krahasim me muajt paraprak. Poashtu në muajin Dhjetor vërehet vlerë shumë e ulët në krahasim me muajt tjerë!!



Fig.11. Emisionet e matura të SO_2 në mg/Nm³, Janar – Dhjetor, 2015

Emisionet e matura të NOx në mg/Nm³

Në fig.12, janë paraqitur emisionet e NOx në Ferronikel, gjegjësisht në furrat rrotulluese nga shihet se gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2015 ka pasur vlera shumë të ulëta nga vlerat e lejuara.pra nuk ka pas tejkalime.



Fig.12. Emisionete e matura të NOx në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2015

3.3. Sharrcem - Vlerësimi i emisioneve në ajër për vitin 2015

Më poshtë janë prezantuar në mënyrë grafike emisionet e Pluhurit, SO_2 dhe NOx në Sharrcem.

Emisionet e Pluhurit në mg/Nm³

Në fig. 13, janë paraqitur emisionet e pluhurit në Sharrcem, gjatë muajve Mars – Dhjetor të vitit 2015. Siç shihet vlerat janë shumë të ulëta në krahasim me vlerën e lejuar.



Fig.13. Vlera mesatare mujore e emisioneve të Pluhurit në mg/Nm³, Mars – Dhjetor, 2015.

Emisionet e SO2 në mg/Nm³

Në fig.14, janë paraqitur emisionet e SO_2 në Sharrcem, nga shihen se vlerat janë shumë të ulëta gjatë muajve Mars – Dhjetor të vitit 2015.



Fig.14. Vlera mesatare mujore e emisioneve të SO_2 në mg/Nm³, Mars – Dhjetor, 2015.

Emisionet e NOx në mg/Nm³

Në fig.15, janë paraqitur emisionet e NOx në Sharrcem, nga shihet se nuk ka tejkalime gjatë muajve Mars – Dhjetor të viti 2015.



Fig.15. Vlera mesatare mujore e emisioneve të NOx në mg/Nm³, Mars – Dhjetor, 2015.

Adresa e AMMK-së:

Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04

Tel. +381 38 200 33 228 , email: kepa@ks-gov.net

www.ammk-rks.net

Prishtinë, 2016